



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndërtesa e "Fakultetit Teknik", 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383-38-548 644

URL: <http://www.fna.uni-pr.edu>

Mail: [fn@uni-pr.edu](mailto:fn@uni-pr.edu)

Ref. nr. 889/3 Prishtinë 09.03.2021

**PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER**

**DEPARTAMENTI KONSTRUKTIV**

Studenti Liridona Durmishi, ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: "Vulnerabiliteti sizmik i strukturave nga betoni i armuar", në programin e studimeve Master konstruktiv dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Ndërtimtarisë. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

**ABSTRAKT**

Në inxhinierinë sizmike, studimi i dëmtueshmërisë së objekteve prej betoni të armuar ka një vend të rëndësishëm për shkak të përhapjes shumë të gjerë të këtyre llojeve të strukturave, një pjesë e të cilave janë projektuar dhe ndërtuar me kodet e vjetra të projektimit që i bën ato më të ekspozuara ndaj rrezikut sizmik. Dëmtueshmëria është një koncept i cili përfshin shumë aspekte të vlerësimit sizmik e jo sizmik të strukturave, siç janë: vulnerabiliteti, matricat e dëmtueshmërisë, kurbat e fraxhilitetit dhe funksioni i humbjeve për të arritur tek risku sizmik. Në këtë temë, duhet të sqarojmë se me termin funksion dëmtueshmërie, apo kurbë dëmtueshmërie i referohemi pikërisht studimit të fraxhilitetit të tipit të strukturave të marrë në shqyrtim, ndërtesat e rëndësishme së veçantë prej betoni të armuar të projektuara dhe ndërtuara pa kritere të mbrojtjes sizmike. Funksionet e dëmtueshmërisë (apo kurbat e dëmtueshmërisë) kanë një rëndësi shumë të madhe jo vetëm në vlerësimin e impaktit të një tërmeti potencial në një strukturë (vulnerabiliteti sizmik) apo edhe në parashikimin e humbjeve të mundshme (monetare e njërzore, risku sizmik) por edhe në planifikimin e masave dhe të strategjive të reagimit në rast tërmeti. Në këtë temë do të kryhen disa analiza për të përfituar kapacitetin e ndërtesës, pikat e performancës për spektra të ndryshëm të kerkesës, lakoret e brishtësisë dhe gjendja e dëmtimit për pikën e dhënë të performancës së ndërtesës.

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimtarisë.